



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 59408-00468-00-2022 Regj. Themeltar
Nr. 00-2025-485 i Vendimit (74).**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

Ilir PANDA	Kryesues
Albana BOKSI	Anëtare
Medi BICI	Anëtar

sot në datë 20.03.2025, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen penale, që i përket:

KËRKUESE: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec

I GJYKUAR: Enkeledi Agastra

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “Përvetësimi i mallrave ose parave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”, parashikuar nga neni 287/b i Kodit Penal.

Viktima: Shoqëria Vodafon Albania SHA

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarës Albana Boksi dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, mbi bazën e materialeve hetimore të ardhura nga Komisariati i Policisë Pogradec, ka regjistruar procedimin penal nr. 467, datë 04.12.2020, në ngarkim të pandehurit Enkeledi Agastra, për kryerjen e veprës penale “Vjedhja me dhunë”, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal (në vijim KP). Gjykimi i kësaj çështje penale është zhvilluar sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar, në gjendjen e akteve të fashikullit të hetimeve, në përputhje me nenet 403 – 406 të Kodit të Procedurës Penale (në vijim KPP).

2. Nga gjykimi i çështjes ka rezultuar se, në datën 27.11.2020, shërbimet e policisë gjyqësore janë njoftuar lidhur me një vjedhje të kryer në dyqanin e shoqërisë telefonike “Vodafone Albania” SHA. Shitësja e dyqanit B.O ka deklaruar se, në datën 27.11.2020 ka qenë në punë në dyqanin “Vodafon”, së bashku me shoqen e saj, M.B. Rreth orës 12:50 ka hyrë në dyqan një person i moshës rreth 22-25 vjeç, me xhup të errët dhe xhins gri dhe

fytyrën të mbuluar me një bluzë në formë golfi. Ky person i është drejtuar shtetasës B.O me fjalët: *“Lekët, kjo është një grabitje”*, duke i drejtuar dhe një armë tip pistoletë të vogël. Shitësja e ka kapur armën nga pjesa e grykës dhe në këtë moment arma është ndarë në dy pjesë. Personi që mbante në dorë pistoletën e ka bashkuar përsëri dhe ia ka drejtuar përsëri shitëses, e cila është përleshur me të. Pasi e ka shtyrë shtetasën B.O, ai ka arritur të marrë një telefon të llojit “Xiaomi A3”, që gjendej në banakun reklamues me vlerë 26.700 lekë dhe është larguar me vrap. Të njëjtat deklaramë ka dhënë edhe shitësja tjetër e dyqanit M.B.

3. Nga shoqëria “Alb Telecom”, në kuadër të këtij hetimi është kthyer përgjigje se numrat IMEI 867117043962855 dhe IMEI 2 8671170439628 kanë përdorur numrin celular, në emër të shtetasit Feti Agastra, babai i të pandehurit Enkeledi Agastra. Pas kontrollit të ushtruar në banesën e këtij shtetasi, në xhepin e xhupit të Enkeledi Agastra është gjetur një telefon celular i markës “Xiaomi”, i cili rezultoi se kishte të njëjtat numra IMEI që ka deklaruar shoqëria e telefonisë celulare. Në vijim, është kryer veprimi hetimor i njohjes së sendit, referuar nenit 172 të KPP, duke i treguar xhupin shtetasës B.O, e cila e njohu si të njëjtën xhup që kishte parë ditën e ngjarjes.

4. Në lidhjet me faktet e verifikuara më sipër, i pandehuri ka deklaruar se aparatën telefonik të sekuestruar në banesën e babait të tij e ka blerë nga një person i quajtur Andrea Olldashi, për shumë 6.000 lekë të reja. Në përfundim të hetimit, prokuroria i ka atribuar të pandehurit akuzën e vjedhjes me dhunë të sendit/aparat celular, vepër penale e parashikuar nga neni 139 i KP.

5. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec** me vendimin nr. (914)-194, datë 27.07.2021, ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të pandehurit Enkeledi Agastra, për kryerjen e veprës penale “Vjedhja me dhunë”, parashikuar nga neni 139 i KP dhe dënimin e tij me gjashtë vjet burgim. Në aplikim të nenit 406/1 të KPP i ulet 1/3 e dënimit dhe dënohet përfundimisht me 4 (katër) vjet burgim. Provat materiale aparati telefonik i sekuestruar me procesverbalin e datës 07.01.2021 mbajtur nga OPGJ t'i kthehet viktimës-shoqërisë “Vodafone” SHA, pasi vendimi të marrë formë të prerë. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Korçë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi”*.

5.1 Gjykata e Shkallës së Parë Pogradec ka arsyetuar se, në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal, gjykata në bazë të nenit 375 të KPP, ka të drejtë të ndryshojë cilësimin juridik të veprës penale, me kusht që të jetë në kompetencën e saj. Në seancën e datës 14.07.2021, prokuroria ka paraqitur konkluzionet përfundimtare për veprën penale të parashikuar nga neni 287/b i KP. Në një situatë procedurale të tillë, meqenëse kërkesa për gjykimin e çështjes është sjellë për gjykimin e akuzës për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i KP, gjykata në bazë të nenit 376 të KPP, i dha të drejtë mbrojtjes të parashitjeve konkluzionet përfundimtare, në lidhje me ndryshimin e akuzës. Gjykata ka konkluduar se, kemi të bëjmë me ndryshim akuze, pasi edhe gjyqtari i seancës paraprake me vendimin nr. (302)-111, datë 31.03.2021 e ka përcjellë çështjen për gjykim themeli, për veprën penale të parashikuar nga neni 139 të KP. Prokuroria parashtroi në konkluzionet përfundimtare, se fakti që i pandehuri e ka blerë celularin e vjedhur 6.000 lekë, ndërkohë që sipas vlerësimit të ekspertit ky send ka vlerën 28.700 lekë, tregon që, ky send ka qenë i vjedhur nga personi që ia ka shitur. Fakti që i pandehuri e ka blerë këtë send pa faturë tregon dijeninë e tij për sendin e vjedhur. Personi që i ka shitur sendin të pandehurit, Andrea Olldashi, ka ndërruar jetë disa ditë më vonë nga koha që i pandehuri i ka blerë celularin, prandaj pyetja e tij është bërë e pamundur. Provat për kryerjen e veprës penale të “Vjedhjes me dhunë” janë të pamjaftueshme.

5.2 I pandehuri i pyetur gjatë hetimeve paraprake, nuk ka pranuar kryerjen e krimit për të cilën akuzohet. Ai deklaroi se, telefonin e sekuestruar e ka blerë në datë 01 ose 02.12.2020. Mbrojtja pretendon se, mungojnë pamjet filmike, në lidhje me ngjarjen. Nëse i pandehuri Enkeledi do e kishte vjedhur telefonin, nuk e do e mbante në shtëpi. Mbrojtja pretendon se, mund të jemi përpara veprës penale, të parashikuar nga neni 287/b i KP “Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose nga veprimtaria

kriminale”, pasi i pandehuri pranon që telefonin e ka blerë nga një person në shumën 6.000 lekë, por nuk ka qenë në dijeni të faktit që ky celular ka qenë i vjedhur.

5.3 Gjykata vlerëson se, nga tërësia e provave që janë shqyrtuar në gjykim, rezulton se, i pandehuri ka kryer veprën penale “Vjedhja me dhunë”, parashikuar nga neni 139 i KP. Ekzistojnë prova të tërthorta të cilat lidhen me njëra-tjetrën dhe krijojnë bindjen gjykatës se, i pandehuri është autori i kësaj vepre penale. Gjykata çmon të evidentojë përmbajtjen e nenit 139 të KP, dispozitë e cila nuk ka pësuar asnjë ndryshim dhe ka këtë formulim: *“Vjedhja e pasurisë e shoqëruar me përdorim dhune dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim”*. Përsa i përket kësaj vepre penale përdorimi i dhunës është element i anës objektive të veprës, kusht i domosdoshëm për përgjegjësi penale dhe që e dallon këtë vepër penale brenda grupit të veprave penale të vjedhjes të Kreut II, Seksionit I.

5.4 Rezultoi e provuar se, të dhënat identifikuese të aparatit telefonik të vjedhur në ngjarjen e datën 27.11.2020, ishin regjistruar në emër të babait të pandehurit Feti Agastra, por që realisht telefoni posedohej nga i pandehuri. Prova tjetër që e lidh me ngjarjen të pandehurin është xhupi, i cili ka veshur i pandehuri ditën e ngjarjes dhe në të cilën është gjetur telefoni i vjedhur. Nga paraqitja për njohje datë 08.01.2021, punonjësja e dyqanit të shitjes së kompanisë Vodafone, ka bërë njohjen e xhupit të gjetur në banesën e babait të pandehurit dhe ka konstatuar se, ka qenë i njëjti xhup që ka veshur autori ditën e ngjarjes.

5.5 Gjykata nisur nga rrethanat e faktit penal, vlerëson se kjo vepër penale është kryer me përdorimin e dhunës, me qëllim vjedhjen e sendit të telefonit. Përdorimi i dhunës ka filluar që në momentin që i pandehuri ka hyrë në dyqan dhe ka nxjerrë pistoletën e imituar, i maskuar, që nga ky moment i pandehuri e ka konsumuar këtë vepër penale. Për efekt të përgjegjësisë penale, nuk mund t’i kërkohej viktimës që të kuptojë nëse autori i krimit po i drejtohet me një armë të vërtetë apo imituese, në një moment tronditje psikologjike të rëndë, perceptimi krijohet për një pistoletë të vërtetë. Në këtë kuptim, kemi të bëjmë fillimisht me një dhunë psikologjike që ka përdorur i pandehuri, por që ka hasur në rezistencën e viktimës. Dhuna psikologjike më pas ka vijuar me dhunën fizike, i pandehuri në kushtet që nuk vodhi shumat monetare për shkak të rezistencës fizike të punonjësës së pikës së vodafonit, ka tentuar të marrë ndonjë send që mund të ishte i kapshëm lehtësisht.

5.6 Në lidhje me pretendimin e organit të akuzës, në konkluzionet përfundimtare se kemi të bëjmë me veprën penale të parashikuar nga neni 287/b i KP, gjykata vlerëson se është i pabazuar. Gjykata çmon të evidentojë përmbajtjen e kësaj dispozite, e cila parashikon se: *“Kushdo që blen, merr, fsheh apo në një mënyrë tjetër përvetëson për vete ose për një palë të tretë apo ndihmon në blerjen, marrjen ose fshehjen ose përdorimin e mallrave të tjerë, duke ditur se një person tjetër ka përfutur këto para apo mallra si pasojë e kryerjes së një vepre penale dënohet me burgim nga gjashtë deri në tre vjet burgim”*. Në rastin konkret, në lidhje me këtë fakt të pretenduar nga organi i akuzës dhe mbrojtja kemi vetëm deklaratimet e pandehurit, i cili tregon se, aparatit telefonik të sekuestruar në banesën e babait të tij, e ka blerë nga një person, i cili quhet Andrea Olldashi, për shumë 6.000 lekë të reja.

5.7 Një indicje tjetër që e rrëzon këtë pretendim për blerje sende të vjedhura është se, aparati telefonik është gjetur në banesën e babait të pandehurit në një kohë relativisht të shkurtër nga dita që ka ndodhur ngjarja, më datë 27.11.2020 dhe aparati telefonik është sekuestruar në banesë në datë 07.01.2021. Ky fakt tregon që ka qenë pikërisht i pandehuri që e ka vjedhur këtë send dhe jo që e ka blerë nga persona të tjerë. Provat e përmendura më sipër, e lidhin të pandehurin me vendin e ngjarjes dhe i krijojnë bindjen gjykatës përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, se kjo vepër penale është kryer nga i pandehuri. Për sa më sipër, gjykata vlerëson se, i pandehuri Enkeledi Agastra duhet të deklarohej fajtor për kryerjen e veprës penale “Vjedhjes me dhunë” parashikuar nga neni 139 i KP.

5.8 Lidhur me caktimin e llojit dhe masës së dënimit, sa i përket rrezikshmërisë së veprës penale në rastin konkret, gjykata mban parasysh mban parasysh llojin e dënimit dhe kufijtë e masës së tij, që parashikohen nga ligji penal. Së dyti, lidhur me rrezikshmërinë e autorit të saj, ky kriter i referohet vlerësimit të mundësisë së autorit që të përsërisë kryerjen e

veprës. Së treti, rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat parashikohen nga nenet 48, 49 dhe 50 të KP. Së katërti, në caktimin e llojit dhe masës së dënimit, gjykata mban parasysh edhe qëllimet e dënimit që ndjek legjislacioni penal i cili është i orientuar drejt një politike penale humane (neni 1/c i KP). Në rastin konkret dëmi i shkaktuar është në shumën prej 28.700 lekë, por sendi i vjedhur është sekuestruar dhe do t'i kthehet viktimës me vendim përfundimtar, prandaj dëmi ekonomik konsiderohet i riparuar. Kjo mbahet në konsideratë për uljen e masës së dënimit në kuptim të nenit 49 të KP. Rezulton se i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë. Në lidhje me mënyrën sesi ka vepruar i pandehuri tregon që ka rrezikshmëri relativisht të lartë, pasi vjedhja është bërë në një mjedis publik në pikën e vodafone SHA në qytetin e Pogradecit, ka përdorur armë imituese, i pandehuri ka pasur qëllim për të vjedhur shumat monetare që ndodheshin në arkë. Gjykata çmon që i pandehuri Enkeledi Agastra meqenëse ka qenë i padënuar më parë, dëmi ekonomik është rikuperuar, nuk ka rrethana rënduese, por nga ana tjetër nuk është treguar bashkëpunues me organet e procedimit, dënimi i tij duhet të jetë pranë minimumit që parashikon neni 139 i KP, me gjashtë vjet burgim.

6. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim i pandehuri Enkeledi Agastra, duke kërkuar: *“Prishjen e vendimit nr. (914)-194, datë 27.07.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe kthimin e akteve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec për t’u gjykuar nga tjetër trup gjykues për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale penale. Në alternativë të sa më sipër nëse nga ana e gjykatës nuk do të merren në konsideratë shkeljet procedurale të kryera nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, ndryshimin e vendimit nr. (914)-194, datë 27.07.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe deklarimin e pafajshëm të pandehurit Enkeledi Agastra, qoftë për sa i përket veprës penale “Vjedhja me dhunë” të parashikuar nga neni 139 i KP, qoftë për sa i përket akuzës së ngritur nga Prokuroria në konkluzionet përfundimtare për veprën penale “Përvetësimi i mallrave ose parave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”, e parashikuar nga neni 287/b i KP.”*

7. Ndaj ankimit të pandehurit ka paraqitur apel kundërshtues Prokuroria, duke kërkuar: *“Konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të ankimit dhe zgjidhjen e procesit penal sipas kërkesës së Prokurorit të Shkallës së Parë.”*

8. Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. 18, datë 11.02.2022 ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 194, datë 27.07.2021 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Pogradec. Kundër vendimit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë brenda 45 ditëve, nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit”.*

8.1 Gjykata e apelit ka arsyetuar se, vendimi gjyqësor nr. (914)-194, datë 27.07.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, është marrë në përputhje me provat që kanë rezultuar në gjykim dhe me ligjin procedural penal dhe material penal, si në lidhje me kualifikimin e faktit të paligjshëm, gjetjen dhe deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale “Vjedhja me dhunë”, parashikuar nga neni 139 i KP, ashtu dhe në lidhje me llojin dhe masën e dënimit për veprën penale dhe nuk ka shkak ligjor për ndryshimin e tij, apo prishjen e tij dhe kthimin e çështjes për rigjykim, por ky vendim duhet të lihet në fuqi, si vendim i drejtë, i bazuar në ligj dhe në prova.

8.2 Në lidhje me llojin dhe masën e dënimit të caktuar për të pandehurin, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka arsyetuar mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprës e shprehur në marzhin e dënimit me burgim dhe përhapjen e saj në vendin tonë; rrethanat e kryerjes së veprës; pasojën e ardhur; rrezikshmërinë shoqërore të autorit që shprehet nga lloji i veprës së konsumuar, nga fakti që është i padënuar më parë, niveli arsimor, sjelljet dhe mënyrat e të vepruarit para dhe pas kryerjes së veprës penale dhe mënyra e kryerjes së veprës; rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat parashikohen nga nenet 48, 49 dhe 50 të KP; qëllimi i dënimit penal. Në përfundim e ka dënuar të pandehurin me 6 vjet burgim dhe në përfitim të uljes së 1/3 të dënimit për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar me 4 vjet burgim.

8.3 Nga ana e organit të prokurorisë u mbajt qëndrimi se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec duhet të lihet në fuqi si i bazuar në ligj dhe në prova, duke mos i qëndruar

apelit kundërshtues të paraqitur nga prokurori i çështjes. Sipas prokurores pranë Gjykatës së Apelit Korçë apeli kundërshtues është paraqitur jashtë afatit ligjor 5 ditor, të përcaktuar në nenin 423 të KPP dhe nuk duhet të merret në shqyrtim. Konkretisht, rezulton se prokurori i çështjes ka marrë dijeni për ankimin e bërë nga mbrojtësi i të pandehurit në datën 15.09.2021 dhe apelin kundërshtues e ka paraqitur në gjykatë në datën 21.09.2021.

8.4 Veprimet hetimore kanë ndodhur në vazhdimësi dhe në një kohë të shkurtër . Më datën 08.01.2021 është bërë paraqitja për njohje e sendit, pra e xhupit të autorit me këtë shtetase. Ky veprim hetimor është kryer konform nenit 171 të KPP, ku shtetësja B.O. është thirrur nga organi procedues. Të gjitha këto veprime janë kryer në prani të mbrojtësit Albi Hoxhallari, i cili ka nënshkruar procesverbalin e njohjes pa asnjë kontestim. Nga sa më sipër, nuk konstatohet asnjë shkelje ligjore nga ana e oficerit të policisë gjyqësore dhe pretendimet e mbrojtjes se ky akt duhet të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm, për shkak se nuk ka qenë i pranishëm mbrojtësi i zgjedhur nga i pandehuri, por mbrojtësi i caktuar kryesisht, nuk sjell pasojën e pavlefshmërisë absolute të tij. Mbrojtësi i zgjedhur nga i pandehuri është njohur me të gjitha veprimet hetimore, përfshirë edhe këtë akt, kanë qenë dakord, nuk e kanë kundërshtuar atë as gjatë hetimit dhe as gjatë gjykimit në seancë paraprake apo të themelit.

8.5 Edhe pretendimi i mbrojtjes për prishjen e vendimit dhe kthimin për rigjykim të kësaj çështje për këtë shkak është i gabuar dhe jo ligjor, pasi veprimi i njohjes së sendit jo vetëm që është kryer konform dispozitës ligjore, të parashikuar nga neni 171 i KPP, por ai është një veprim hetimor i papërsëritshëm. Në pretendimet e tij mbrojtësi deklaron se nuk është respektuar neni 375/2 i KPP, në të cilin citohet se: *“Kur në përfundim të shqyrtimit gjyqësor gjykata vlerëson se fakti për të cilin akuzohet i pandehuri mund të ketë cilësim juridik më të rëndë se ai që ka bërë prokurori ose viktimë akuzuese, njofton palët mbi këtë mundësi dhe u jep kohën e nevojshme për t’u mbrojtur. Palet kanë të drejtë të paraqesin prova të reja”*. Edhe ky pretendim i mbrojtësit nuk qëndron. Procedimi penal është regjistruar nga prokurori për veprën penale “Vjedhja me dhunë”, parashikuar nga neni 139 i KP, shtetasi Enkeledi Agastra është ndaluar dhe pyetur si person ndaj të cilit zhvillohen hetimet në prani të mbrojtësit, por për këtë vepër penale, është marrë në përgjegjësi penale dhe është pyetur me cilësinë e të pandehurit në prani të mbrojtësit po për këtë vepër penale, janë përfunduar hetimet dhe çështja është dërguar në gjykim, ku gjyqtari i seancës paraprake, për këtë vepër penale e ka dërguar çështjen për gjykimin e themelit të saj.

8.6 Në gjykimin paraprak i pandehuri dhe mbrojtësi i tij kanë parashtruar mbrojtjen e tyre ndaj kësaj vepre penale, të parashikuar nga neni 139 të KP dhe kanë mbajtur qëndrim se nuk ndodhemi përpara kësaj vepre penale, por para veprës penale “Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”, parashikuar nga neni 287/b i KP, duke kërkuar dhe kthimin e çështjes për plotësim hetimesh, por pavarësisht kësaj kanë kërkuar gjykim të shkurtuar. Në seancën e themelit ku është pranuar procedura e gjykimit të shkurtuar, i pandehuri është gjykuar për akuzën e parashikuar nga neni 139 i KP. Vetëm në konkluzionet përfundimtare prokurori i çështjes ka kërkuar deklarinimin fajtor për kryerjen e veprës penale, të parashikuar nga neni 287/b i KP. Po kështu, mbrojtësi i të pandehurit në konkluzionet përfundimtare ka paraqitur mbrojtjen e tij, duke parashtruar se nuk jemi përpara veprës penale, të parashikuar nga neni 139 i KP, por përpara veprës penale të parashikuar nga neni 287/b i KP, duke shprehur dhe pendim të thellë për këtë vepër penale.

8.7 Fakti që i pandehuri është deklaruar fajtor nga gjykata për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i KP, nuk është një fakt i ri, është fakti për të cilin ka filluar procedimi penal, është marrë në përgjegjësi penale i pandehuri, është dërguar në gjyq dhe është gjykuar. Në rastin konkret, në të gjitha këto faza i pandehuri dhe mbrojtësi kanë parashtruar pretendimet e tyre, duke u mbrojtur ndaj këtij fakti, duke e kundërshtuar atë dhe duke referuar tek një vepër tjetër penale. Pra, zbatimi i nenit 375/2 të KPP, i cili i jep mundësi palëve për mbrojtjen e një fakti të ri në rastin konkret është zbatuar, pasi palët e kanë ezauruar mbrojtjen e tyre në të gjitha fazat e hetimit dhe gjykimit pikërisht për këtë fakt që i pandehuri është deklaruar fajtor.

8.8 Gjykata e Apelit Korçë, pasi shqyrtoi ankimin e paraqitur, çmoi aktet e administruara në fashikullin gjyqësor dhe pasi dëgjoi pretendimet e palëve, vlerëson që vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, duhet të lihet në fuqi dhe se shkaqet e parashtruara në ankim nuk janë të bazuara dhe ligjore. Nga ana e mbrojtësit u pretendua se procedura për njohjen e sendit nga shtetësja B.O., në datën 08.01.2021 është bërë në kundërshtim me rregullimin e parashikuara në nenin 171, pika 4 të KPP pasi prezent gjatë zhvillimit të procedurës ka qenë mbrojtësi i caktuar kryesisht nga organi procedues, në kushtet kur personi nën hetim që në datën 07.01.2021, kur është pyetur me këtë cilësi, ka zgjedhur një mbrojtës. Në fakt rezulton se në datën 07.01.2021, shtetasi Enkeledi Agastra është pyetur si person nën hetim në prani të Av. Gerond Stefo si mbrojtës i zgjedhur nga familjarët e tij, ndërsa në datë 08.01.2021 procedura për njohjen e sendit është bërë në prani të Av. Albi Hoxhallari, i thirrur kryesisht nga organi procedues.

8.9 Gjykata e apelit vlerëson se neni 428, pika 1, germa “ç” e KPP, parashikon “*kur nuk janë respektuar dispozitat që lidhen me pjesëmarrjen e të pandehurit, të mbrojtësit të tij...*”, është fjala për dispozitat që lidhen me pjesëmarrjen e të pandehurit dhe mbrojtësit në gjykim, si njoftimi i rregullt i tyre, dhe jo për situatën e paligjshmërisë së pretenduar nga mbrojtësi në këtë gjykim. Gjykata e apelit vlerëson se edhe nëse do të ishte shkelur rregullimi i nenit 171, pika 4 të KPP, kjo nuk sjell si pasojë prishjen e vendimit gjyqësor dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

8.10 Nga ana tjetër, gjykata e apelit çmon se në procedurën për njohjen e sendit nga shtetësja B.O., nuk ka shkelje të ndonjë dispozite urdhëruese të ligjit, me pasojë pavlefshmërinë absolute, pasi i pandehuri dhe mbrojtësi e kanë humbur të drejtën të kërkojnë deklarimin e pavlefshmërisë relative të aktit, që kërkohet gjatë seancës paraprake dhe deri sa nuk është çelur shqyrtimi gjyqësor në shkallë të parë, për më tepër që aktet janë pranuar në gjendjen që ato janë, për shkak se në seancë paraprake është kërkuar procedimi me gjykim të shkurtuar, kërkesë që i është qëndruar dhe para trupit gjykues të gjykit të akuzës në themel. Sipas nenit 171 pika 4, të KPP, njohja bëhet në prani të mbrojtësit, pa kërkuar detyrimisht praninë e mbrojtësit të zgjedhur, që mund të mungojë për arsye objektive dhe në rastin në gjykim, në këtë procedurë organi procedues është siguruar për mbrojtjen e të drejtave të personit nën hetim për shkak se ka siguruar praninë e një mbrojtësi dhe në momentin e njohjes ky mbrojtës nuk ka shfaqur ndonjë pretendim apo dhe mbrojtësi i zgjedhur kur është njohur me këtë akt nuk ka ngritur ndonjë pretendim se përse nuk është njoftuar për realizimin e njohjes. Në këtë procedurë janë respektuar rregullimet e neneve 171-173 të KPP.

8.11 Nga ana e mbrojtësit është mbajtur qëndrimi se janë shkelur dispozitat për paraqitjen e akuzave të reja, me pasojë prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim. Në nenin 376, pika 1 të KPP, parashikohet se: “*1. Në rastet e parashikuara nga nenet 372, 373, 374 dhe 375, kryetari i bën të ditur të pandehurit se mund të kërkojë një afat për mbrojtjen. Kur i pandehuri kërkon afat, kryetari ndërpret shqyrtimin gjyqësor për një kohë të përshtatshme, por jo më shumë se dhjetë ditë. Edhe palët e tjera mund të kërkojnë marrjen e provave të reja*”. Gjykata e apelit vlerëson se këto rregullime ligjore duhet të lexohen në mënyrë të kujdesshme dhe të mos interpretohen në mënyrë abuzive për të passjellë prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, pasi duhet të interpretohen në mënyrë pajtuese me parimet e tjera procedurale, siç është ajo e një gjykate të paanshme që nuk e paragjykon çështjen. Nëse gjykata do të respektonte në çdo rast nenin 375, pika 1 dhe 376, pika 1 të KPP, ajo do të paragjykonte vendimmarrjen për çështjen. Kjo pasi vendimi për ndryshimin e kualifikimit të faktit të paligjshëm merret si vendim përfundimtar, në dhomë këshillimi nga gjykata e tërhequr, pasi i është dhënë fund shqyrtimit/diskutimit gjyqësor dhe në këtë rast shtrohet pyetja a ka gjykata mjet procedural që pasi të vendosë në dhomë këshillimi për ndryshimin e cilësimit të faktit, të rikthehet në seancë për të riçelur hetimin gjyqësor dhe për t’i bërë me dije palëve se “ka ndërmend” të ndryshojë cilësimin e faktit të paligjshëm, e t’u lërë kohë për të përgatitur mbrojtjen? Parashikime procedurale për këtë rast nuk ka. Nëse në përfundim të

shqyrtimit gjyqësor gjykata i bën me dije të pandehurit se fakti mund të ketë cilësim juridik të ndryshëm a më të rëndë, a nuk përbën kjo një paragjykim për vendimmarrjen?

8.12 Për t'u rikthyer në rastin në gjykim, rezulton se nuk jemi përpara një akuze të re, por përpara ndryshimit të cilësimit juridik të faktit kriminal dhe së dyti, gjykata e apelit mbështet konstatimet e prokurores pranë Gjykatës së Apelit se shtetasi Enkeledi Agastra është hetuar për veprën penale "Vjedhja me dhunë", parashikuar nga neni 139 i KP dhe në hetim ka bërë mbrojtjen e tij, duke mohuar akuzën e duke shpjeguar se sendin celular të gjetur atij, e kishte blerë. Ky shtetas është marrë nën akuzë për veprën penale "Vjedhja me dhunë", parashikuar nga neni 139 i KP dhe prokurori ka kërkuar para gjyqtarit të seancës paraprahe dërgimin e çështjes në gjykim për këtë akuzë, kërkesë e pranuar me vendimin gjyqësor nr. (302)-111, datë 31.03.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec. Para gjyqtarit të seancës paraprahe nga ana e të pandehurit dhe mbrojtësit është kërkuar që çështja me procedurën e gjyqimit të shkurtuar të dërgohet për gjykim, për akuzën "Përvetësimi i mallrave ose parave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale", e parashikuar nga neni 287/b i KP. Akuza është ndryshuar nga prokurori vetëm gjatë konkluzioneve përfundimtare të parashtruar prej tij, ndërsa i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale "Përvetësimi i mallrave ose parave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale", e parashikuar nga neni 287/b i KP, duke kërkuar dënimin me periudhën e vuajtur prej tij nën masën e sigurimit personal "arrest në burg", ose nëse dënohet me një dënim me burgim më të gjatë të aplikohet alternativa e ekzekutimit të dënimit me burgim, parashikuar në nenin 59 të KP.

8.13 Gjykata, edhe pse nuk e ka shprehur në dispozitiv, rezulton nga arsyetimi i vendimit, se e ka ndryshuar kualifikimin e faktit të paligjshëm nga vepra penale e parashikuar nga neni 287/b i KP, në veprën penale "Vjedhja me dhunë", parashikuar nga neni 139 i KP në bazë të nenit 375/1 të KPP. Referuar sa më sipër, gjykata e apelit çmon se nuk ka pasur vend për t'i lënë kohë të pandehurit për të përgatitur mbrojtjen, pasi ai është hetuar dhe gjykuar për veprën penale, të parashikuar nga neni 139 i KP, duke parashtruar në çdo fazë procedurale të hetimit dhe gjyqimit paraparak qëndrimin e tij për këtë akuzë. Ndërsa, prova të reja nuk mund të kërkonte, pasi gjykimi ishte zhvilluar me procedurën e gjyqimit të shkurtuar, mbi kërkesë të vetë të pandehurit, kërkesë që ai e ka parashtruar edhe pse akuza e komunikuar ishte e ajo e "Vjedhjes me dhunë", parashikuar nga neni 139 i KP. Pra, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, ka respektuar nenin 375, pika 1 të KPP dhe nuk ka shkelur të drejtën e mbrojtjes efektive të të pandehurit.

8.14 Gjykata e apelit çmon se nuk ka shkak ligjor për të kontestuar kontrollin e vendeve, konkretisht kontrollin e banesës së shtetasit Feti Agastra, ky veprim hetimor si mjet për gjetjen e provës është bërë në kushtet e ngutshmërisë së krijuar nga mundësia që sendi të zhduej, në bazë të nenit 202/3 të KPP, në lidhje me nenin 298 të KPP, menjëherë pasi policia gjyqësore është vënë në dijeni se celulari i vjedhur është përdorur nga shtetasi Feti Agastra. Por, edhe nëse kontrolli do të ishte i paligjshëm, celulari XIAOMI dhe xhupi ku është gjetur janë rrjedhojë e kontrollit personal të shtetasit Enkeledi Agastra dhe e sekuestrimit si veprim procedural, i kryer në bazë të nenit 207, pika 2 të KPP dhe i vlerësuar brenda afatit ligjor nga prokurori i çështjes.

8.15 Gjykata e Apelit Korçë vlerëson gjithashtu se nuk ka vend as për ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Enkeledi Agastra për veprën penale "Vjedhja me dhunë", parashikuar nga neni 139 i KP. Fakti i paligjshëm provohet nga procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe nga deklaratimet e shtetaseve B.O. dhe M.B. shitëse në dyqanin Vodafone SHA Pogradec. Këto shtetase kanë qenë nën dhunë psikologjike të shkaktuar nga përdorimi prej subjektit aktiv kriminal të një sendi në pamje të parë pistoletë, që i ka detyruar "të dorëzojnë pasurinë". Me të drejtë nuk është ngritur akuzë për veprën penale "Vjedhja me armë", parashikuar nga neni 140 i KP, pasi ky send nuk është mundur të sekuestrohet për t'iu nënshtruar ekspertimit

dhe në një moment, kur shtetësja B.O. e ka kapur tytën e pistoletës ajo është hapur në mes, krijon bindjen se nuk ka qenë pistoletë që plotëson kushtet e ligjit “Për armët”.

8.16 Në lidhje me autorësinë, dy shitëset e dyqanit kanë bërë përshkrimin e veshjes së autorit dhe deklaratimet e tyre përputhen në lidhje me xhupin me ngjyrë të errët, që kishte veshur autori (shitëset kanë kontradikta në deklaratim nëse autori kishte veshur pantallona apo tuta, megjithëse dakordësojnë për ngjyrën), por në lidhje me përshkrimin e xhupit kanë dhënë të njëjtin përshkrim. Pikërisht xhupi që mbante veshur autori është ai që i përket të pandehurit ku është gjetur telefoni i vjedhur, i cili gjithashtu sipas përgjigjes së kompanisë celulare është përdorur nga një numër telefoni i regjistruar në emër të Feti Agastra, babait të të pandehurit. Ndryshe nga sa mbrojtja pretendon, nuk ka asnjë shkak që të vihet në dyshim njohja e xhupit nga ana e shtetësjes B.O, e cila është shprehur se nëse e sheh përsëri është e sigurt që do ta njohë. Këto prova në lidhje me njëra- tjetrën krijojnë edhe tek gjykata e apelit bindjen se autori i veprës penale është i pandehuri Enkeledi Agastra. Nga ana e mbrojtësit të të pandehurit shtrohen një sërë pyetjesh, që nuk është detyrë e organit procedues për t’iu përgjigjur. Gjykata nuk mund të deklarojë të pafajshëm të pandehurin, përballë provave si më sipër që provojnë fajësinë, për shkak se sipas mbrojtësit nuk ka logjikë që i pandehuri të vazhdojë të përdorë të njëjtin xhup që ka përdorur në ngjarje.

8.17 Nga ana e të pandehurit është mbajtur qëndrimi se sendi është blerë prej tij rreth datës 01-02.12.2020, tek shtetasi Andrea Olldashi, i cili është gjetur i vdekur në një kanal së bashku me vëllain e tij, rreth datës 20.12.2020, fakt i njohur botërisht për shkak se është pasqyruar në çdo mjet të informimit masiv. Pra, edhe gjykata mund të aludojë se i pandehuri ka ngritur këtë alibi, pasi nuk mund të kundërshtohet nga i ndjeri Andrea Olldashi, por gjykata nuk mund të aludojë, ashtu si palët procedurale nuk mund ta bëjnë.

8.18 Gjykata e apelit e konsideron të përshtatshme dhe masën e dënimit të caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec për të pandehurin, duke pasur parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, rrethanat e kryerjes dhe pasojën e ardhur, rrezikshmërinë e të pandehurit që është i padënuar me parë, por dhe qëndrimin e tij mohues, shprehje e rrezikshmërisë së tij shoqërore. Pra, në përfundim, gjykata e apelit çmon se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec duhet të lihet në fuqi si i bazuar në prova dhe në ligj. Gjykata e apelit çmon të mos shprehet për pretendimet e prokurorit të çështjes të parashtruara në apelin kundërshtues, pasi ai është depozituar jashtë afatit ligjor 5 ditor nga e nesërmja e marrjes dijeni për ankimin e të pandehurit, i parashikuar në nenin 423 të KPP, ashtu siç solli në vëmendje të gjykatës se apelit dhe vetë Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Korçë dhe se kjo e fundit nuk i qëndroi apelit kundërshtues.

9. Kundër vendimit nr. 18, datë 11.02.2022 të Gjykatës së Apelit Korçë, **ka paraqitur rekurs, më datë 11.05.2022 i gjykuari Enkeledi Agastra**, duke kërkuar: *“Prishjen e vendimit nr. (914)-194, datë 27.07.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe kthimin e akteve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec për t’u gjykuar nga tjetër trup gjykues për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale penale. Në alternativë sa më sipër, nëse nga ana e gjykatës nuk do të merren në konsideratë shkeljet procedurale të kryera nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, ndryshimin e vendimit nr. (914)-194, datë 27.07.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe deklaratimin e pafajshëm të pandehurit Enkeledi Agastra, qoftë për sa i përket veprës penale “Vjedhja me dhunë”, të parashikuar nga neni 139 i KP, qoftë për sa i përket akuzës së ngritur nga Prokuroria në konkluzionet përfundimtare për veprën penale “Përvetësimi i mallrave ose parave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”, e parashikuar nga neni 287/b i KP. Në mënyrë të përmbledhur, në rekurs janë parashtruar këto shkaqe:*

- Së pari nga ana e OPGJ janë shkelur dispozitat për kontrollin e vendeve, duke ushtruar kontroll në banesën e të pandehurit, pa pasur në dispozicion një vendim kontrolli nga gjykata dhe pa qenë në kushtet e flagrancës, në kundërshtim me nenin 37 të Kushtetutës. Kontrollat e banesës, si dhe të mjediseve që njësohen me të, mund

të bëhen vetëm në rastet dhe në mënyrat e parashikuara me ligj (...). Referuar parashikimit kushtetues të mësipërm, kontrolli i banesës dhe vendeve është parashikuar në mënyrë të detajuar në nenet 202-207 të KPP, të cilat janë shkelur në mënyrë flagrante në rastin konkret. Rezultatet e marra nga kontrolli i banesës së shtetasit Feti Agastra nuk mund të përdorshin, pasi janë marrë në kundërshtim me parashikimet kushtetuese dhe ligjore, referuar nenit 151/3 të KPP. Pavarësisht nëse një fakt i tillë nuk pretendohet nga palët, papërdorshmëria mund të konstatohet kryesisht. Një fakt i tillë nuk është konstatuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe as nga Gjykata e Apelit Korçë.

- Shkeljet e ligjit procedural penal kanë vazhduar me veprimin procedural të njohjes së sendit (xhupit), të realizuar në datë 08.01.2021. Më konkretisht referuar nenit 171/4, parashikohet se: *“Njohja bëhet në prani të mbrojtësit...”* Gjithashtu pika 5 e nenit 171, parashikon se: *“Mosrespektimi i rregullave të parashikuara nga ky nen përbën shkak për pavlefshmërinë e njohjes”*. Ky veprim procedural megjithëse është bërë pasi i pandehuri kishte zgjedhur mbrojtës që në datë 07.01.2021, nuk është bërë në prezencë të mbrojtësit të zgjedhur, por është bërë në prezencë të mbrojtësit të caktuar kryesisht. Referuar këtij fakti dhe parashikimit të nenit 49/6 të KPP, mbrojtësi i caktuar mund të zëvendësohet vetëm për shkaqe të përligjura. Veprimi procedural i njohjes së sendit pa prezencën e mbrojtjes përbën shkak për pavlefshmërinë e këtij veprimi procedural. Referuar nenit 128/a, germa “c”, ky rast përbën një nga rastet e pavlefshmërisë absolute dhe si e tillë duhej të konstatohet kryesisht.
- Gjatë veprimit të njohjes, nga ana e personit që do të bënte njohjen nuk është bërë një përshkrim i detajuar i sendit që do të njihej. Arsyetimi dhe interpretimi i gjykatës, vjen ndesh me frymën e ligjit procedural penal dhe parimet themelore të një gjykimi të drejtë të barabartë dhe të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenet 1 dhe 2 të KPP. Këto rregulla janë të detyrueshme
- Gjatë hetimeve paraprake çmuarja e pavlefshmërisë bëhet nga prokurori dhe nëse nuk kryhet nga ku i fundit çmohet nga gjyqtari i seancës paraprake. Pavarësisht se në rastin konkret, procesi gjyqësor është zhvilluar me procedurën e gjykimit të shkurtuar, për sa i përket mosprezencës së mbrojtësit të zgjedhur gjatë veprimit të njohjes, jemi në kushtet e një akti absolutisht të pavlefshëm, bazuar në nenin 128, pika 1, germa “c” e KPP që sjell pavlefshmërinë e të dy vendimeve.
- Në rastin konkret, megjithëse i pandehuri pas konkluzioneve të prokurorisë akuzohet për veprën penale të parashikuar nga neni 287/b i KP, Gjykata nuk ka njoftuar palët për mundësinë e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale, nuk e ka pasqyruar as në dispozitivin e vendimit, shkak për prishjen dhe kthimin për rigjykim të çështjes. Në kushtet kur është lejuar shkelja e neneve 202- 207, 151, 49, 171 dhe 375 të KPP jemi në kushtet e nenit 441, germa “ç” të KPP.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal

10. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) vlerëson se, në lidhje me këtë çështje ka rëndësi të theksohet fakti i ndryshimeve ligjore që ka pësuar KPP, si me ligjin nr. 35/2017 (hyrë në fuqi në datë 1 gusht 2017), edhe me ligjin nr. 41/2021 (hyrë në fuqi në datën 29.05.2021). Ky konstatim ka rëndësi në raport me momentin e depozitimit të rekursit, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të KPP me ligjin nr. 35/2017, ndërkohë që hetimi dhe gjykimi në shkallë të parë ka filluar para hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve ligjore. Ndërkohë, neni 38 i ligjit nr. 41/2021, mbi dispozitat tranzitore parashikon: *“1. Përbërja e trupave gjyqës, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera. 2. Rekursi e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre”*. Në kuptim të kësaj

dispozite, në lidhje me formimin e trupit gjykues si dhe procedurën e gjykimit, Kolegji Penal zbaton parashikimet e ligjit nr. 41/2021, ndërsa në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së rekursit i referohet ligjit procedural që ka qenë në fuqi në kohën e depozitimit të tij

11. Kolegji vlerëson se rekursi i paraqitur nga i gjykuari plotëson kriteret formale të pranueshmërisë dhe është depozituar brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 435 të KPP. Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Korçë është njoftuar për rekursin e paraqitur me anë të aktit “Dëftesë komunikimi”. Shkaqet e rekursit në Gjykatën e Lartë parashikohen nga neni 432 i KPP. Kjo dispozitë, në pikën 1 të saj, parashikon se rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet kur: nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji material ose procedural, i cili është me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; ose kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

12. Kolegji çmon paraprakisht të theksojë se Gjykata e Lartë është një gjykatë ligji, të cilës palët mund t’i drejtohen vetëm për shkaqet e përcaktuara në nenin 432 të KPP. Pretendimet në lidhje me vlerësimin e gabuar të fakteve dhe provave, nuk merren në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, pasi kjo është një çështje që del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të saj. Pavarësisht se Gjykata e Lartë nuk i hyn vlerësimit të provave është në kompetencën e saj që të shqyrtojë nëse nga gjykatat më të ulëta është zbatuar drejt ligji dhe nëse vendimmarrja e tyre është në përputhje me standardet e një vendimmarrje të arsyetuar, duke marrë për bazë edhe qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata Europiane e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.

13. Nga përmbajtja e vendimeve të gjykatave të fakti, tërësia e akteve të marra e të verifikuara në këtë proces penal, Kolegji në referim të pikës 1 të nenit 432 të KPP, vlerëson se ka shkaqe për cenimin e vendimmarrjes së gjykatave të faktit ndaj të gjykuarit Agastra. I gjykuari pretendimet në themel të rekursit të tij, i ka fokusuar në drejtim të zbatimit të gabuar të ligjit procedural penal e konkretisht, neneve 202- 207, 151, 49, 171 dhe 375 të KPP, që sipas tij e kanë çuar gjykatën (gjykatat) në konkluzione të gabuara, atë të deklarimit fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 139 i KP. I gjykuari ka kërkuar deklarimin e pafajshëm të tij për kryerjen e veprës penale “Vjedhja me dhunë”, të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal dhe për veprën penale “Përvetësimi i mallrave ose parave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”, e parashikuar nga neni 287/b i Kodit Penal.

14. Kolegji vëren se gjykatat e faktit kanë mbajtur qëndrim të njëjtë lidhur me cilësimin juridik të faktit penal në ngarkim të të pandehurit, duke e kualifikuar atë si “Vjedhje me dhunë”, të parashikuar nga neni 139 i KP, si dhe në lidhje me llojin, masën e dënimit e mënyrën e vuajtjes së tij. Gjykatat në unison kanë vlerësuar se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm kryerja e veprës penale “Vjedhja me dhunë”, parashikuar nga neni 139 i KP, referuar provave të administruara gjatë hetimit të kësaj çështje, gjykimi i së cilës ka vijuar me procedurën e gjykimit të shkurtuar

15. Kolegji konstaton se gjatë gjykimit në shkallë të parë, në seancën e datës 14.07.2021, gjatë dhënies së konkluzioneve përfundimtare me shkrim, prokurori ka ndryshuar qëndrimin e tij lidhur me akuzën, duke kërkuar deklarimin fajtor të të pandehurit Agastra, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 287/b të Kodit Penal. Në seancë gjyqësore prokurori ka mbajtur qëndrimin se, nuk ka ndryshuar akuzë në mënyrë që të merrej një vendim sa më objektiv nga gjykata. Gjykata lidhur me situatën e re procedurale në përfundim të gjykimit, ka vendosur t’i japë kohë mbrojtjes për të përgatitur konkluzionet lidhur me akuzën e re, sipas qëndrimit të prokurorit në diskutimin përfundimtar.

16. Lidhur me këtë moment procedural, të kontestuar nga mbrojtja edhe në ankim, Gjykata e Apelit Korçë ka arsyetuar se, *edhe pse nuk e ka shprehur në dispozitiv, rezulton nga arsyetimi i vendimit, se e ka ndryshuar kualifikimin e faktit të paligjshëm nga vepra*

penale e parashikuar nga neni 287/b i KP, në veprën penale “Vjedhja me dhunë”, parashikuar nga neni 139 i KP në bazë të nenit 375/1 të KPP. Referuar sa më sipër, Gjykata e Apelit çmon se nuk ka pasur vend për t’i lënë kohë të pandehurit për të përgatitur mbrojtjen, pasi ai është hetuar dhe gjykuar për veprën penale, të parashikuar nga neni 139 i KP, duke parashtruar në çdo fazë procedurale të hetimit dhe gjykimit paraprak qëndrimin e tij për këtë akuzë. Ndërsa prova të reja nuk mund të kërkonte, pasi gjykimi ishte zhvilluar me procedurën e gjykimit të shkurtuar, mbi kërkesë të vetë të pandehurit, kërkesë që ai e ka parashtruar edhe pse akuza e komunikuar ishte e ajo e “Vjedhjes me dhunë”, parashikuar nga neni 139 i KP.

17. Kolegji parashtroi rrethanat sa më lart, pasi çmon se nga ana e prokurorisë fillimisht, por edhe nga gjykatat e faktit nuk janë kuptuar e zbatuar drejt dispozitat për akuzat e reja. Fakti që në një nga seancat gjyqësore, konkretisht gjatë diskutimit përfundimtar, prokurori i çështjes ka kërkuar që i pandehuri të deklarohet fajtor për akuzën “Përvetësimi i mallrave ose parave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”, e parashikuar nga neni 287/b i Kodit Penal, duhet të ishte analizuar nga gjykatat në raport me faktet e atribuuara këtij të gjykuari dhe në funksion të garantimit të drejtave të tij të mbrojtjes. Kolegji konstaton se pas “saktësimit të akuzës” nga prokurori i çështjes gjatë diskutimit përfundimtar, gjykata i ka lënë afat mbrojtjes për të përgatitur diskutimin përfundimtar duke i vënë në dukje edhe këtë fakt (ndryshimin e akuzës). Kolegji, duke patur në vëmendje analizën e fakteve të atribuuara të gjykuarit Enkeledi Agastra, në raport me aktin e njoftimit të akuzës dhe kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq të prokurorisë, si dhe në raport me qëndrimin përfundimtar të prokurorisë dhe konkluzionet e arritura nga gjykatat e faktit – vlerëson se në rastin konkret janë shkelur dispozitat për paraqitjen e akuzave të reja, e lidhur kjo edhe me mosrespektimin e të drejtës së pandehurit për tu mbrojtur në mënyrë efektive për akuzën që i është atribuuar. Në radhë të parë, Kolegji rithekson se gjykatat duhet të kenë në konsideratë kuptimi i termave “fakt penal”, “akuzë”, “vepër penale” dhe “cilësim juridik”. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në jurisprudencën e saj ka theksuar se, ‘akuza’ është njoftimi zyrtar nga ana e autoritetit kompetent, i faktit që lidhet me kryerjen e një vepre penale. ‘Natyra e akuzës’ është cilësimi juridik që u bëhet fakteve në akt-akuzë. ‘Shkaku i akuzës’ janë faktet materiale për të cilat akuzohet i pandehuri (shih vendimet e GJEDNJ, Kamasinski kundër Austrisë, datë 19.12.1989; Pelissier e Sassi kundër Francës; Drassich kundër Italisë etj.). Në referim të jurisprudencës së GJEDNJ, me rëndësi në funksion të garantimit të të drejtave kushtetuese dhe procedurale të pandehurit është komunikimi i akuzës, me të gjitha elementet e saj të renditura më lart.

18. Edhe Gjykata Kushtetuese në lidhje me atribuimin e akuzës dhe ndryshimin e cilësimit juridik (shih vendimin nr. 24/2012), mes të tjerave ka argumentuar: “E drejta e individit për t’u vënë në dijeni menjëherë dhe në mënyrë të hollësishme mbi natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij, është sanksionuar nga neni 31/a i Kushtetutës dhe nga neni 6/3/a i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). ... Gjykata vëren se qëllimi i këtyre dispozitave është të krijojnë mundësinë për të akuzuarin të njihet paraprakisht me materialet, provat dhe rezultatet e hetimit, në mënyrë që të ushtrojë të drejtën e tij për të përgatitur një mbrojtje efektive, pra për të paraqitur argumentet në favor të tij dhe për të kundërshtuar akuzën e ngritur (shih vendimin nr. 4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese). 10. Në lidhje me të drejtën e mbrojtjes, Gjykata në jurisprudencën e saj të konsoliduar, ka theksuar se ajo duhet të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë t’i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (shih vendimet nr. 37, datë 19.09.2011; nr. 25, datë 10.06.2011; nr. 5, datë 17.02.2003 dhe nr. 33, datë 24.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese). ...”.

19. Kolegji vë në dukje se neni 372 i KPP (ndryshimi i akuzës) i jep mundësi prokurorit të vlerësojë situatën kur fakti në gjykim del ndryshe nga ç’është paraqitur në

kërkesën për gjykim. Nëse ndodhemi përpara një situatë të tillë, prokurori vepron vetë me ndryshimin e akuzës si subjekti që ushtron ndjekjen penale. Për mënyrën sesi procedon prokurori për ndryshimin e akuzës, nuk parashikohet ndonjë detaj apo hollësi nga neni 372 i KPP. Megjithatë, Kolegji vlerëson të sjellë në vëmendje jurisprudencën e Kolegjit Penal (duke theksuar se këto dispozita nuk kanë pësuar ndryshime që nga miratimi i KPP), ku është përcaktuar sesi duhet të procedojë prokurori, kur ndodhet përpara rastit të ndryshimit të akuzës, duke theksuar: “...Sipas nenit 372, 373 e 374 të KPP është organi i prokurorisë ai që ndryshon akuzën, akuzon për një vepër tjetër që lidhet me atë që gjykohej, apo akuzon për një fakt të ri i cili nuk është përmendur në kërkesën për gjykim. Në këto raste, gjykata nuk ka për detyrë të miratojë qëndrimin e prokurorit lidhur me akuzën, por është e detyruar të vazhdojë gjykimin me akuzën e re, ose të ndryshuar, me kushtin që në bazë të nenit 376 të KPP ti bëjë të ditur të pandehurit se ai ka të drejtë për një afat kohor për tu mbrojtur kundrejt akuzës së re, ose të ndryshuar...”. (shih vendimin nr. 636 datë 25.11.2009)

20. Nga ana tjetër, ligji procedural penal ka parashikuar se gjykata mund të bëjë ndryshimin e cilësimit juridik/rikualifikimin ligjor të faktin kriminal (neni 375 i KPP). Por në këtë rast, gjykata mund të rikualifikojë të njëjtin fakt që është përshkruar në akuzë apo në kërkesën për gjykim dhe jo një fakt të ri, i cili përmban elemente apo rrethana të reja që nuk i janë njoftuar të pandehurit apo për të cilat prokuroria nuk ka ushtruar ndjekjen penale. Kolegji vë në dukje se, me “fakt që rezulton ndryshe” duhet të kuptojmë një fakt që paraqitet ndryshe në mënyrë tërësore, nga ai i parashtruar në kërkesën për gjykim. E thënë ndryshe, gjykata në emër të dhënies së drejtësisë, nuk legjitimohet të vlerësojë ato veprime apo mosveprime të të pandehurit, të cilat ndonëse rezultojnë gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk i janë atribuar të pandehurit me aktin e njoftimit të akuzës apo në kërkesën për gjykim. Nëse do të ndodhte kjo gjë, cenohet e drejta e të pandehurit për proces të rregullt ligjor, si: e drejta e tij për t’u mbrojtur, e drejta për t’u dëgjuar, e drejta për akses në gjykatë, etj. Gjykata ushtron të drejtën e saj për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, vetëm në lidhje me faktin e përshkruar në kërkesën për gjykim, që i është njoftuar/komunikuar të pandehurit dhe për të cilin prokuroria ka ushtruar ndjekjen penale, duke i atribuar një akuzë konkrete. Në përmbledhje të këtij parashtrimi, Kolegji rithekson se neni 372 rregullon rastin kur fakti penal (shkaku i akuzës) rezulton gjatë shqyrtimit gjyqësor ndryshe nga sa është përshkruar në aktin e njoftimit të akuzës dhe në kërkesën për gjykimin e të pandehurit. Ndërkohë, në zbatimin e nenit 375 të Kodit Penal, fakti nuk ndryshon por cilësimi juridik i tij (natyra e akuzës) rivlerësohet nga gjykata në përputhje me parimin *jura novit curia* (gjykata e njeh ligjin), pra fakti që i atribuohet të pandehurit nuk ndryshon dhe mbetet i njëjtë. Fakti i njëjtë do të thotë “i njëjti fakt objektiv” i cili karakterizohet nga të njëjtat veprime, subjekte dhe objekt material. Pra, “fakti i njëjtë” do të thotë që fakti jo vetëm në tërësinë e tij të jetë i njëjtë, por edhe se asnjë element i tij përbërës nuk duhet të rezultojë të jetë i ndryshëm nga ajo që është përcaktuar në akuzën e paraqitur nga prokurori (shih vendimin nr. 00-2024-1166 (150), datë 27.06.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).

21. Duke ju rikthyer çështjes konkrete, Kolegji konstaton se fakti penal që i është atribuar të gjykuarit Enkeledi Agastra në këtë proces penal, është përshkruar në aktin e njoftimit të akuzës dhe në kërkesën për gjykim – vjedhje me dhunë të sendit aparat celular duke përdorur një send në dukje si armë (send ky i fundit që nuk është gjetur). Akuza është ndryshuar/saktësuar nga prokurori vetëm gjatë konkluzioneve përfundimtare të parashtruara prej tij, duke pranuar që akuza e vjedhjes me dhunë në ngarkim të gjykuarit nuk qëndron. Prokuroria në konkluzionet përfundimtare ka pranuar qëndrimin e mbrojtjes (ndonëse në apel dhe në rekurs i gjykuari ka pretenduar pafajësi) duke pohuar se, *fakti që i pandehuri e ka blerë celularin e vjedhur 6.000 lekë, ndërkohë që sipas vlerësimit të ekspertit ky send ka vlerën 28.700 lekë, tregon që, ky send ka qenë i vjedhur nga personi që ia ka shitur. Fakti që i pandehuri e ka blerë këtë send pa faturë tregon dijeninë e tij për sendin e vjedhur. Personi që i ka shitur sendin të pandehurit, Andrea Olldashi, ka ndërruar jetë disa ditë më vonë nga*

koha që i pandehuri i ka blerë celularin, prandaj pyetja e tij është bërë e pamundur. Provat për kryerjen e veprës penale të “Vjedhjes me dhunë” janë të pamjaftueshme.

22. Kolegji vlerëson jo të drejtë e ligjor këtë qëndrim të prokurorit të çështjes, i cili në thelb ka ndryshuar akuzën në diskutimin përfundimtar, ndonëse gjykimi është zhvilluar në gjendjen e akteve të fashikullit hetimor, për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar. Kjo do të thotë që shqyrtimi gjyqësor i çështjes nuk ka ndikuar në këtë “saktësim të akuzës” nga prokurori, përse kohë nuk është verifikuar asnjë provë apo rrethanë apo fakt i ri/i ndryshëm në raport me aktet/provat e përfshira në fashikullin e hetimeve (pikërisht pasi gjykimi është zhvilluar mbi aktet e hetimit). Më tej, Kolegji thekson se edhe qëndrimi i gjykatës nuk është i argumentuar ligjërisht. Gjykata e apelit, në raport me vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë që ka konkluduar për fajësinë e të gjykuarit për akuzën e vjedhjes me dhunë, ka argumentuar se, *edhe pse nuk e ka shprehur në dispozitiv, rezulton nga arsyetimi i vendimit, se e ka ndryshuar kualifikimin e faktit të paligjshëm nga vepra penale e parashikuar nga neni 287/b i KP, në veprën penale “Vjedhja me dhunë”, parashikuar nga neni 139 i KP në bazë të nenit 375/1 të KPP. Referuar sa më sipër, gjykata e apelit çmon se nuk ka pasur vend për t’i lënë kohë të pandehurit për të përgatitur mbrojtjen, pasi ai është hetuar dhe gjykuar për veprën penale, të parashikuar nga neni 139 i KP, duke parashtruar në çdo fazë procedurale të hetimit dhe gjykimit paraprak qëndrimin e tij për këtë akuzë. Ndërsa, prova të reja nuk mund të kërkonte, pasi gjykimi ishte zhvilluar me procedurën e gjykimit të shkurtuar, mbi kërkesë të vetë të pandehurit, kërkesë që ai e ka parashtruar edhe pse akuza e komunikuar ishte e ajo e “Vjedhjes me dhunë”, parashikuar nga neni 139 i KP. Pra, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, ka respektuar nenin 375, pika 1 të KPP dhe nuk ka shkelur të drejtën e mbrojtjes efektive të të pandehurit.* Kolegji vlerëson se ky konkluzion i gjykatës së apelit është i pabazuar ligjërisht.

23. Në lidhje me akuzat e reja, Kolegji vë në dukje se nenet 372, 373 dhe 374 të KPP nuk kanë pësuar ndryshime me ligjin 35/2017 apo me ligjin 41/2021, ndërsa ‘ndryshimi i cilësimit juridik të veprës’, parashikuar nga neni 375 i KPP, ka ndryshuar (me ligjin 35/2017) në raport me mënyrën sesi procedon gjykata, kur ajo arrin në konkluzionin se faktit penal duhet t’i japë një përcaktim të ndryshëm ligjor nga ai që ka bërë prokurori ose viktimja akuzuese (pika ‘1’ e kësaj dispozite). Ky parashtrim ka rëndësi për të kuptuar nëse në rastin konkret, qëndrimi i prokurorisë për saktësimin e akuzës/cilësimit juridik të fakteve të atribuara të gjykuarit, i referohet të njëjtave fakte apo nëse këto fakte kanë rezultuar ndryshe nga sa ishte përshkruar në kërkesën për gjykim. Prokurori në parashtrimin e këtij qëndrimi duhet të kishte argumentuar përse fakti i atribuuar të gjykuarit, në kushtet kur në këtë proces nuk janë marrë prova të tjera apo nuk ka pasur debat gjyqësor mbi provat, nuk është vjedhje me dhunë (siç është theksuar në aktin e njoftimit të akuzës dhe në kërkesën për gjykim), por përvetësim i sendeve të vjedhura.

24. Kolegji vë në dukje se gjykata e shkallës së parë pasi është njohur me diskutimin përfundimtar të prokurorit, i ka bërë me dije të pandehurit dhe avokatit të drejtën për realizimin e mbrojtjes në raport me veprën penale që është referuar nga prokurori në diskutimin përfundimtar, sipas nenit 287/b të KP. Në vijim rezulton se mbrojtësi i të gjykuarit kur ka parashtruar konkluzionet përfundimtare, duke shprehur dhe pendim të thellë në raport me veprën penale të parashikuar nga neni 287/b të KP (por në apel dhe në rekurs ka pretenduar pafajësinë e tij në raport me faktin penal të atribuuar). Sa më sipër, Kolegji vlerëson se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec nuk ka respektuar dispozitat procedurale për paraqitjen e akuzave të reja, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit si dhe ka shkelur të drejtën e mbrojtjes efektive të të pandehurit. Gjykata e shkallës së parë në thelb nuk ka vlerësuar qëndrimin e prokurorit në diskutimin përfundimtar të çështjes, duke çmuar e analizuar provat e marra në këtë proces, në raport me akuzën e vjedhjes me dhunë. Nga ana tjetër, gjykata e apelit këtë konkluzion të gjykatës së shkallës së parë e ka argumentuar si ndryshim të cilësimit juridik të faktit penal (pra jo ndryshim akuze), duke mbështetur dënimin e të pandehurit Agastra për veprën penale “Vjedhja me dhunë” (neni 139 i KP). Kolegji çmon se

në fakt këto qëndrime të gjykatave të faktit kanë rënduar “in pejus” pozitën e të pandehurit, pasi prokurori në fund ka pranuar se provat janë të pamjaftueshme për të mbështetur akuzën e vjedhjes me dhunë në ngarkim të gjykuarit Enkeledi Agastra. Ky qëndrim i prokurorit në raport me akuzën fillestare të atribuuar të gjykuarit nuk është analizuar nga gjykatat, për të konkluduar nëse fakti penal është i njëjtë apo i ndryshëm; cila provë apo rrethanë ka ndikuar në këtë ndryshim qëndrimi të prokurorit; nëse ky ndryshim apo saktësim i akuzës nga ana e prokurorit është i bazuar në ligj; e për më tepër, në këto rrethana procedurale, duhej analizuar me kujdes nëse të gjykuarit i janë garantuar të drejtat e mbrojtjes apo jo, si gjatë hetimit ashtu edhe në gjykim (duke pasur parasysh se të drejtën e ushtrimit të ndjekjes penale e ka prokurori).

25. Kolegji vë në dukje se në asnjë rast respektimi i nenit 375, pika 1 dhe 376, pika 1 të KPP, nuk përbën një paragjykim për vendimmarrjen, ashtu siç ka arsyetuar gjykata e apelit, por garanton të drejtën e të pandehurit për mbrojtje efektive në procesin penal ndaj tij. Kolegji risjell në vëmendje në këtë rast, edhe qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 4/ 2012, ku është theksuar: “27.... Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se ky institut mund të aplikohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, gjatë gjykimit të zakonshëm, vetëm kur zbatohen në mënyrë rigorozë kërkesat e përcaktuara nga vetë Gjykata, në mënyrë të veçantë në lidhje me garantimin e realizimit të së drejtës së mbrojtjes të palëve në gjykim ndaj formulimit të ri të veprës penale. “Zbatimi në këtë mënyrë i kërkesave të nenit 375 të KPP-së, është një garanci për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, duke e vënë gjykatën në rolin që i takon për dhënien e drejtësisë” (shih vendimin nr.50, datë 30.07.1999 të Gjykatës Kushtetuese)...”. Po ashtu, në lidhje me institutin në shqyrtim, GJEDNJ është shprehur se, dispozitat e paragrafit 3 të nenit 6 sanksionojnë nevojën që t’i jepet një kujdes i veçantë njoftimit të “akuzës” të interesuarit. Duke qenë se akt-akuza ka një rol të rëndësishëm në procedimin penal, neni 6, paragrafi 3 i njeh të pandehurit të drejtën që të informohet jo vetëm me motivin e akuzës, pra me faktet materiale që i atribuohen dhe mbi të cilat bazohet akuza, por edhe, dhe në mënyrë të detajuar, me kualifikimin juridik të dhënë këtyre fakteve (shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen *Pélissier dhe Sassi kundër Francës*, nr. 25444/94, § 51). Në vijim, GJEDNJ ka theksuar edhe se, ... një informacion i saktë dhe i plotë i akuzave në ngarkim të një të pandehuri pra dhe i kualifikimit juridik të veprës penale që autoritetet mund të konsiderojnë në ngarkim të tij, është një kusht i rëndësishëm për procesin e rregullt ligjor (shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen *Drassich kundër Italisë*, kërkesa nr. 25575/04). Në rastin konkret, ndonëse gjykimi është bazuar vetëm në aktet e dosjes e prokurorit, ky i fundit në diskutimin përfundimtar ka pranuar se provat janë të pamjaftueshme për të mbështetur akuzën që ai ka ngritur, “Vjedhje me dhunë”, parashikuar nga neni 278/b i KP. Gjykatat e faktit përpara se të vijonin me analizën e provave, duhet të analizonin dhe të argumentonin këtë qëndrim të prokurorit, nëse jemi para ndryshimit apo tërheqjes së akuzës; çfarë pasoje ka për akuzën ky qëndrim i prokurorit dhe a është i bazuar ligjërisht.

26. Në përfundim, Kolegji çmon se shkaqet në rekursin e të gjykuarit referojnë në pikën 1, shkronja “b” të nenit 441 të KPP, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pasi janë shkelur dispozitat për paraqitjen e akuzave të reja dhe e drejta e të gjykuarit për tu mbrojtur në raport me këtë akuzë. Rrjedhimisht, i gjithë procesi gjyqësor i zhvilluar në shkallë të parë është i vesuar në mënyrë të tillë, saqë e vetmja zgjidhje për riparimin e tij gjendet në nenin 441/1, shkronja ‘ç’ të KPP, pra zhvillimi i gjykimit nga e para pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, duke garantuar të drejtat e mbrojtjes së gjykuarit në raport me faktin penal të atribuuar dhe akuzën (duke mbajtur në konsideratë analizën e cituar më lart në këtë vendim). Sa më sipër, Kolegji vlerëson se duhet disponuar për prishjen e vendimit nr. 18, datë 11.02.2022 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe të vendimit nr. (914)-194, datë 27.07.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë (për shkak të riorganizimit të rretheve gjyqësore, sipas vendimit nr. 495, datë 21.07.2022 “Për

riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencat tokësore të gjykatave” të Këshillit të Ministrave).

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 441, pika 1, shkronja “ç” të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S I:

Prishjen e vendimit nr. 18, datë 11.02.2022 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe të vendimit nr. (914)-194, datë 27.07.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Tiranë, më 20.03.2025

Vërtetohet njësia me origjinalin. Adm.Gjyq.VD